e) Bisedë me nxënësit në klasë një ditë përpara vizitës në _____.

Biseda do të zhvillohet rreth njohurive që kanë nxënësit mbi fushën në të cilët zhvillohet veprimtaria mësimore.

Nxënësit mund të plotësojnë në mënyrë individuale pjesën e parë të: “Fletë pune 1” dhe më pas të zhvillohet biseda me ta.

- f) Pritshmëritë që kanë nxënësit për vizitën në _____
Njihen nxënësit me veprimtarinë që do të zhvillojnë (Vizitë në _____) dhe u kërkohet të japin mendimin e tyre mbi pritshmëritë që kanë: Çfarë mendoni se do të shihni? Për cilët elementë keni më shumë interes? A mendoni se vizita në _____ do të zhvillojë më shumë njohuritë që ju keni në këtë fushë?

Plotësojnë nxënësit Fletë pune 2 “Pritshmëritë e mia”

- g) U jepen nxënësve udhëzime e detyra të qarta për vizitën në _____ që do të jenë të bazaar në objektivat e këtij mësimi.

Vëzhgimi i kujdesshëm i _____

Fotografimi i produkteve dhe materialeve që i bëjnë më shumë përshtypje.

Jepen udhëzime për rregullat që duhet të zbatohen gjatë vizitës në _____ (të folurit me zë jo të lartë, të dëgjuarit me vëmendje e personit që do t’i prezantojë procedurat, makineritë, etj).

6. Zhvillimi i vizitës në _____

Mësuesi gjatë gjithë kohës ndjek me vëmendje sa të interesuar janë nxënësit dhe sa i zbatojnë rregullat në mjedisin e punës

7. Veprimtari pas vizitës

Pas vizitës, në klasë mësuesi zhvillon bisedë me nxënësit rreth vizitës së zhvilluar në _____.

Bisedë rreth mbresave që patën.

Nxjerrin nxënësit “Fletë pune 2” dhe plotësojnë në kolonën e dytë sesa nga pritshmëritë e tyre u realizuan.

U jepet nxënësve një detyrë që mbështet në vëzhgimet që bënë gjatë vizitës, si:

Ese përshkruese: “Një ditë në _____”, “Si prodhohet _____” etj, në varësi të fushës e qëllimit.

Përcaktohet afati i kryerjes së detyrës dhe jepen kriteret e vlerësimit

Fletë pune 2

Pritshmëritë e mia

Gjatë vizitës në ____ mendoj që do të mësoj më shumë për:	
1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	

Fletë pune 3

Intervistë me _____

Përgatit 3 pyetje që do t'i bësh një punonjësi të _____, i cili do vijë për një bisedë në klasë.

1. _____

2. _____

3. _____

Rekomandime për hartimin e planit analitik vjetor të praktikave profesionale në AP

MBËSHTETUR NË UDHËZUESIT E AKAFP, modulet e praktikave profesionale, duhet të zhvillohen sipas një plani mësimor të detajuar të mbështetur në përshkruesit e dhënë në skeletin e kurrikulës. Plani mësimor vjetor është më i hollësishëm dhe i detajuar sesa programi i modulit, duke pasqyruar mundësitë e shkollës, nivelin e nxënësve dhe bashkëpunimin me biznesin.

Para hartimit të planit duhet të mbahet parasysh:

1. Një analizë fillestare mbi:

- a) Nivelin e hyrjes së nxënësve. Si përshtaten nxënësit e mi në këtë modul?
 - Niveli i njohurive për temën, zhvillimi i tyre fizik, psikologjik, kultura nga ata vijnë
- b) Përmbajtjen e hollësishme të lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara
 - Njohja nga ana e mësuesit e të gjithë temave dhe nëntemave, koncepteve,
 - Zotërimi i aftësive të nevojshme për modulin
- Si mundet që me njohuritë dhe aftësitë që unë zotëroj si mësues të ndihmoj nxënësit?
- A jam unë duke zhvilluar të rritur të shëndetshëm e funksionale me mësimdhënien time?
- A mbulojnë RM-të e planifikuara në skeletin e kurrikulës të gjithë kompetencat që nxënësi duhet të arrijë në këtë modul?
- Sa i qëndrojnë ato kohës?
- c) Dhe shkalla e integritit të modulit,
 - Sa është e mundur që këto moduli praktik të integrohet me modulin teorik dhe me lëndë të tjera?
 - A mund të koordinohen me modulet e praktikës?

- A është e mundur të realizohen qëllimet e modulit nëpërmjet projekteve lëndore dhe ndër-lëndore?

d) Objektivat konkretë që do të arrihen,

- Cilat janë kompetencat profesionale që duhet të arrijë nxënësi në fund të kryerjes së moduleve?

e) Mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore të nevojshme për këtë modul.

- A ka mjedise të përshtatshme të të nxënit për zhvillimin e moduleve, apo duhet të zhvillohen në mjedise të tjera (biznes)?
- Cilat nga temat ofrojnë mundësi për vizita në kompani, të ftuar në klasë, video, etj.

f) Mundësitë për bashkëpunim të personelit mësimdhënës dhe stafit drejtues të shkollës.

- Mënyra e organizimit të orareve të përshtatshme e fleksibël për arritjen e qëllimit të modulit.

2. Vlerësimi i arritjeve.

A përfshin vlerësimi tri fushat?:

- Zhvillimin e afësive muskulare dhe koordinimin (psikomotor),
- A rritjen e qëndrimeve dhe vlerave (afektive) dhe
- Fitimin e njohurive dhe aftësive intelektale (konjitive)
- A mundem të hartoj instrumente vlerësimi të përshtatshme për të tri fushat e mësipërme?

Hapat që duhet të ndiqen për hartimin e planit:

- *Përzgjidh rezultatin mësimor që duhet zotëruar.*
- *Përcaktoni performancën e pranuar për nxënësit*
- *Përzgjidhni veprimtaritë që do ta çojnë nxënësin drejt zotërimit*
- *Zhvillon rubrika për të vlerësuar arritjet e nxënësve*

*RISHIKONI DHE RISHIKONI DERISA ÇDO KOMPONENT I MODULIT TË MBËSHTETË
TJETRIN.*

Çdo plan vjetor i praktikës duhet të përmbajë në faqen e parë:

- ✓ Numrin e moduleve me orët përkatëse të çdo moduli.
- ✓ Periudhën kohore kur do të zhvillohet çdo modul
- ✓ Numrin e orëve për javë
- ✓ Kompetencat profesionale që duhet të fitojë nxënësi në fund të lëndës.

Nëse analiza e mësipërme është bërë si duhet, atëherë në plan duhet të jenë të përcaktuara saktë: vendi ku do të zhvillohet moduli, instrumentat e vlerësimit, periudha kohore për RM-të.

Për veprimtaritë që do të zhvillohen në biznes, instruktori duhet të përgatisë plan për çdo nxënës dhe të njohë mentorin me listën e plotë të kompetencave që nxënësi duhet të arrijë gjatë praktikës në biznes.

A i arrin nxënësi të gjitha rezultatet e dëshiruara mësimore nga zhvillimi praktikës në biznes?
Nëse jo, cilat veprimtari shtesë duhet të planifikojë mësuesi?

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Përdorimi i instrumenteve të vlerësimit

Krahas vëzhgimit e listave të kontrllit sygjerohet të përdoren dhe: dosja e nxënësve, projekti, skeda vlerësimi për punën në grup, për të cilat mund të jepen udhëzime të mëtejshme nëse mësuesit do t'i aplikojnë në punën e tyre.

Model plani vjetor

Plani vjetor i praktikës profesionale

Shkolla Profesionale _____ . – Qyteti _____

Viti shkollor 2018-2019

Drejtimi/Profili profesional, Niveli **II**, klasa **12**

Mësuesi:

Lënda: _____

Orë gjithsej: **orët totale të praktikësë**

Module **Numri i moduleve për lëndën**

Moduli 1: **emri i modulit**

Orë gjithsej _____

Periudha kohore(**20 shtator- 30 nëntor_p,sh**)

Kompetenca t ëpërgjithshme që do të arrijë nxënës në fund të modulit:

-- (do të shkruhen duke u mbështetur te skelet kurrikuli, duke u mbështetur te **përshtshmëria që kanë me modulën përkatës**)

--

Kompetencat profesionale që duhet të arrijë nxënësi në fund të modulit:

-- (do të shkruhen duke u mbështetur te skelet kurrikuli, duke u mbështetur te **përshtshmëria që kanë me modulën përkatës**)

Nr	Rezultatet mësimore/ periudha	Veprimtaritë mësimore	lloji	Koha/ Orë mësimore	Instrumentet e vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin	Shënime
1	-plotsohen duke u mbështetur në skelet kurrikul :	- plotsohen duke u mbështetur në skelet kurrikul	T		Në varësi të llojit të ëveprimtarisë do të shënohen dhe instrumentate vlerësimit	B		Kjo kolonë do të shërbejë për të pasqyruar ndryshimet që mund të bëhen në planifikim.
		:	Pp			K		
		:	Vb					
2								
3								

T- teori

b- biznes

Pp – punë praktike

k- klasë

VB- vizitë në biznes

Udhëzues për Konkursin e Kulinarisë



Shkolla “Hamdi Bushati”

Organizimi i Konkursit të Kulinarisë

Ky është një udhëzues për zhvillimin e një konkursi mësimor, gjatë javës së praktikave profesionale, për nxënësit e shkollës Hamdi Bushati në fushën e kuzhinës dhe pasticerisë. Aktiviteti përfshin një grup nxënësish që kanë punuar më përpara në kuzhinë dhe kanë fituar njohuri dhe aftësi praktike në këtë fushë. Grupet e punës mund të jenë krijuara ose pritet që të krijohen. Propozohet që të nxënësit e klasave të 10 të punojnë me nxënës të tjerë më me eksperiencë. Ata pritet që gjatë aktivitetit të përdorin sa më mirë njohuritë e fituara në shkollë, në biznes dhe nga aktivitetet e tjera ekstrakurrikulare si dhe t'i shnderrojnë ato në art gatimi.

Datë ___/11/2018

Shkolla: “_____”

Konkurs në kuzhinë: “Përgatitja një menuje me të njëjtët përbërës”

Klasa: _____, _____, _____

Modulet që integrohen:

Qëllimi mësimor:

Qëllimi afektiv:

Qëllimi psikomotor:

Objektivat:

RM-të që do të arrihen:

Metoda që do të përdoret: Konkursi mësimor, punë në grupe

Koha e realizimit: __ orë mësimore,

Pjesëmarrësit: (nxënës që do të jenë në skuadra dhe nxënës që do të ndjekin konkursin)

Juria: _____

Hapat që do të ndiqen

- Prezantimi i qëllimit të konkursit mësimor nga mësuesi organizator.
- Ndarja e skuadrave dhe përcaktimi i numrit të nxënësve në një skuadër (duke u mbështetur në parapëlqimin e tyre për veprimtarinë). Skuadrave mund t'i vendoset dhe një emër që ka lidhje me ushqimin e kuzhinën.
- Drejtimi i konkursit nga mësuesi organizator.
 1. Përzgjedhja e ushqimeve bazë që do të përdoren nga të tria skuadrat.
 2. Përcaktimi i kohës së përgatitjes së gatimit të parë (antipasta, ose supa, apo sallata).
- Ndërkohë që nxënësit punojnë për përgatitjen e ushqimit, nxënës që janë pjesëmarrës (audiencë), të parapërgatitur, mund të lexojnë ose shfaqin me video, PPT, kuriozitete për përbërësit e përdorur.
- Prezantimet nga liderët e skuadrave

Nëse nxënësit do të gatuajnë pjatë të parë, të dytë e ëmbëlsirë atëherë konkursi do të bëhet me tri ndalesa, duke proceduar si më lart.

- Cilësia e përgatitjes së specialiteteve të menusë kryhet nga anëtarët e jurisë të cilët vendosin dhe pikët, pasi shpallin kriteret.
- Nxënësit pjesëmarrës si audiencë mund të japin pikët e tyre për elementë të dukshëm të punës dhe rregullat e përgatitjes së ushqimeve (në varësi të kushteve të zhvillimit dhe mundësive të materialeve, kjo mund të zhvillohet me votim, me stikera, etj)

Gjatë kohës që skuadrat punojnë, mund të caktohet dhe nga një nxënës që të llogaritë kaloritë për secilën pjatë.

3. Shpallja e pikëve totale për secilën skuadër dhe skuadra fituese.
4. Përmbyllja e veprimtarisë nga mësuesi organizator.

Pas zhvillimit të konkursit mund të organizohet orë mësimore ku nxënësit të japin feedback-un e tyre në lidhje me veprimtarinë:

- Ç'gjë u pëlqeu më shumë?
- Ç'gjë të re mësuam?
- Nëse do të ishin vetë te konkuruesit çfarë mund të kishin bërë ndryshe?
- Si dhe të japin ide për veprimtari të tjera që mund të organizohen.

(Këto mund të jenë në formë bashkëbisedimi, ose me fleta pune që mund të futen në dosjen e secilit nxënës.)

Receta e konkursit

Konkurset në fushën e kulinarisë ndihmojnë pjesëmarrësit për të zhvilluar aftësitë dhe kompetencat e tyre në kuzhinë, si dhe për të vënë në jetë ide të reja në fushën e kulinarisë. Për të siguruar cilësi në pjatën e gatuar dhe për të standardizuar gjykimin, është shumë e rëndësishme që përpara konkursit nxënësve ti dorëzohet informacioni mbi ingredientët dhe recetën/mënyrën si do të gatujnë.

Receta

Emri i pifatës/pijatave: _____

Ingredientët:

Sasia:

Metoda e gatimit:

Skuadra:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Organizimi i konkurseve të kuzhinës

Gjatë ditës së aktivitetit të gjithë grupet pjesëmarrëse në konkurs duhet të përgatiten për të realizuar dhe paraqitur me profesionalizëm dhe cilësi të gjitha gatimet dhe pjatat me të cilat do konkurojnë. Aktiviteti mund të zhvillohet sipas hapave të mëposhtëm:

Hapat	Koha	Çfarë?	Personi përgjegjës
Pjesa 1 Hapja & Ndarja ne grupe	09:00 - 10:00 30'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i rregullave të konkursit • Qëllimi dhe objektivat e konkursit • Prezantimi/ndarja e grupeve 	•
Realizimi & vezhgimi	Pjesa 2 120'	<ul style="list-style-type: none"> • Nxenesit pjesemarrës realizojnë detyrat • Nxeensit vezhgues mbajnë shenim & pyesin • Vëzhgim i grupeve të punës nga ekspertë të kulinarisë • Dokumentimi i procesit të realizimit të recetës duke respektuar kriteret e cilësis 	•
Pjesa 3 Përgatitja dhe prezantimet finale	10:40 – 11:00 20'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i gatimeve të realizuara para jurisë • Gjatë prezantimit para jurisë të kihen parasysh rregullat e shërbimit të ushqimit tek klient si: <i>mbajtja e dorës, mbajtja e pjatës, qendrimi i trupit etj.</i> 	•

Zgjedhja e realizimeve më të mira

Për përzgjedhjen e fituesve kemi një juri prej 3 personash e cila vlerëson gatimet e realizuara në bazë të disa kritereve të përcaktuara. Kriteret lidhen me paraqitjen profesionale, mbajtjen mirë të mjedisit të punës dhe respektimin e kohës, përdorimin me kujdes të produkteve dhe ruajtjen e

shijes, komunikimi në ekip si dhe aparenca e gatimit. Forma e vlerësimit që do përdoret nga juria është si më poshtë:


FORMAT VLERËSIMI		
Emri i grupit _____		Vlerësuesi _____
Pjesëmarrësit e grupit		
1. _____		
2. _____		
3. _____		
4. _____		
5. _____		
Kategoritë e vlerësimit	Pikët mundshme	Pikët e marra
RREGULLI NË VENDIN E PUNËS DHE KOHA	Total 15	
• Veshja e paraqitja korrekte sipas standardeve (uniforma, higjena personale etj.)	5	
• Trajtimi dhe rregullimi i të gjitha materialeve dhe mjeteve të punës, humbjeve dhe faktorëve ekonomikë, sigurisë dhe higjienës, përdorimi i burimeve.	5	
• Përdorimi korrekt i kohës gjatë punës për të siguruar përfundimin e përpiktë.	5	
<i>Total për kategorinë 1</i>		
TEKNIKA & KREATIVITIT E GATIMIT	Total 25	
• Prgatitja e ingredienteve (mise en place)	10	
• Proceset e gatimit & kreativiteti	15	
<i>Total për kategorinë 2</i>		
SHIJA	Total 20	
• Harmonia mes ingredientëve	10	
• Cilësia në gatim	10	
<i>Total për kategorinë 3</i>		
PAMJA E GATIMIT	Total 20	
• Kombinimi i ngjyrave	10	
• Vendosija e ushqimit në pjatë	10	
<i>Total për kategorinë 4</i>		
SKUADRA	Total 20	
• Organizimi dhe komunikimi në ekip	10	
• Angazhimi dhe motivimi i ekipit	10	
<i>Total për kategorinë 4</i>		
Pikë total		

Referenca

<http://co4h.colostate.edu/resources/state-fair/score-sheets/judging-guides/ColoradoGuideForFoodJudges.pdf>
<https://spinachtiger.com/hoë-to-officially-judge-food-competitions-at-the-world-food-championships-eat-method/>

https://www.etiquettescholar.com/dining_etiquette/gourmet_guide/food/judging_food.html
<http://www.caribbeanhotelandtourism.com/mbrsonly/Manuals/CulinaryCompetition.pdf>
http://iek-siteias.las.sch.gr/attachments/article/333/10th_ICCSE-Rules&Regulations-2.pdf
https://www.acfchefs.org/download/documents/Competitions/Culinary_Competition_Manual.pdf

Konkurs në Modë dhe Dizajn



Shkolla “Hamdi Bushati”

Ky është një udhëzues për zhvillimin e një konkursi mësimor, gjatë javës së praktikave profesionale, për nxënësit e shkollës Hamdi Bushati të degës Konfeksion. Aktiviteti përfshin disa grupe nxënësish që kanë ide dhe dëshirë realizimin e krijimeve artistike në fushën e modës të cilat nxjerrin në pah aftësitë dhe njohuritë e tyre në këtë fushë. Konkursi është parashikuar me dy faza. Në fazën e parë nxënësit do duhet të punojnë me materiale të riciklueshme dhe në fazën e dytë ato do përdorin lëndë të parë të pa përdorur për të realizuar krijimet e tyre. Grupet e punës mund të jenë të krijuara ose pritjet që të krijohen. Propozohet që nxënësit e klasave të 10 të punojnë me

nxënës të tjerë më me eksperiencë. Ata pritet që gjatë ditës së aktivitetit të realizojnë me sukses disa veshje sipas kushteve dhe temës së konkursit.

Datë ___/11/2018

Shkolla: “_____”

Klasa: _____, _____, _____

Modulet & Lendet që integrohen:

Qëllimi mësimor:

Qëllimi afektiv:

Qëllimi psikomotor:

Objektivat:

RM-të që do të arrihen:

Metoda që do të përdoret: Konkursi mësimor, punë në grupe

Koha e realizimit: ___ orë mësimore,

Pjesëmarrësit: klasat dhe numri i nxënësve (nxënës që do të jenë në skuadra dhe nxënës që do të ndjekin konkursin)

_____	_____
_____	_____
_____	_____

Juria: _____

Hapat që do të ndiqen:

- Prezantimi i qëllimit të konkursit mësimor nga mësuesi organizator.
- Ndarja e skuadrave dhe përcaktimi i numrit të nxënësve në një skuadër
- Drejtimi i konkursit nga mësuesi organizator.

Përzgjedhja e aksesorit që do të përgatitet nga të tria skuadrat.

- Përcaktimi i kohës së përgatitjes.
- Ndërkohë që nxënësit punojnë për përgatitjen e aksesorit (me të gjitha hapat e kërkuara), nxënës që janë pjesëmarrës (audiencë), të parapërgatitur, mund të lexojnë ose shfaqin me video, PPT, kuriozitete për xhinset: historiku, përdorimi, etj.
- Prezantimet nga liderët e skuadrave.
- Cilësia e përgatitjes së aksesorit kryhet nga anëtarët e jurisë të cilët vendosin dhe pikët, pasi shpallin kriteret.
- Nxënësit pjesëmarrës si audiencë mund të japin pikët e tyre për elementë të dukshëm të punës dhe rregullat e përdorimit të mjeteve të punës (në varësi të kushteve të zhvillimit dhe mundësive të materialeve, kjo mund të zhvillohet me votim, me stikera, etj)

Gjatë kohës që skuadrat punojnë, mund të caktohet dhe nga një nxënës që të llogaritë secila skuadër ka përdorur më me efikasitet copën e pantallonave.

Pjesa dytë e konkursit:

Me të njëjtat material të dizenojnë veshje të ndryshme.

Veprohet si në pjesën e parë

5. Shpallja e pikëve totale për secilën skuadër dhe skuadra fituese.
6. Përmbyllja e veprimtarisë nga mësuesi organizator.

Pas zhvillimit të konkursit mund të organizohet orë mësimore ku nxënësit të japin feedback-un e tyre në lidhje me veprimtarinë:

- Ç'gjë u pëlqeu më shumë?
- Ç'gjë të re mësuam?
- Nëse do të ishin vetë te konkuresit çfarë mund të kishin bërë ndryshe?
- Si dhe të japin ide për veprimtari të tjera që mund të organizohen.

(Këto mund të jenë në formë bashkëbisedimi, ose me fleta pune që mund të futen në dosjen e secilit nxënës.)

Organizimi i konkurseve në modë dhe dizajn

Gjatë ditës së aktivitetit të gjithë grupet pjesëmarrëse në konkurs duhet të përgatiten për të prezantuar në mënyrë sa më të prekshme, praktike dhe të plotësuar idenë e tyre. Aktiviteti mund të zhvillohet sipas hapave të mëposhtëm:

Hapat	Koha	Çfarë?	Personi përgjegjës
Hapja	09:00 - 09:30 30'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i rregullave të konkursit • Objektivat e konkursit • Prezantimi i juries • Prezantimi i grupeve 	•
Pjesa 1 RIKIKLIMI	9.30 – 11.00 90'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i idese dhe qellimit te detyres • Nxenesit punojne ne grupe per: <ul style="list-style-type: none"> ○ Skicimin/ideimin ○ Realizimin • Juria vezhgon realizimin e projektit 	•
Pjesa 2 REALIZIM VESHJE	11:00 – 13:00 120'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i idese dhe qellimit te detyres • Nxenesit punojne ne grupe per: <ul style="list-style-type: none"> ○ Skicimin/ideimin ○ Realizimin • Juria vezhgon realizimin e projektit 	•
Pjesa 3 Përgatitja dhe	13:00 – 13:30 30'	<ul style="list-style-type: none"> • Prezantimi i ideve të finalizuara tek juria <i>Prezantimi të jetë i plotësuar me të gjitha elementet duke nisur që nga</i> 	•

prezantimet
finale

modelja e deri tek aksesoret
shoqërues të veshjes
Rregulli i çdo prezantimi: 10 minuta
prezantim sa më terheqes

Zgjedhja e ideve më të mira

Për përzgjedhjen e fituesve kemi një juri prej 3 personash e cila vlerëson idetë e prezantuara në bazë të disa kriterëve të përcaktuara. Kriteret lidhen me kreativitetin, origjinalitetin, përdorimin e materialeve, praktikitetin, punën në grup dhe inspirimin. Forma e vlerësimit që do përdoret nga juria është si më poshtë:

FORMAT VLERËSIMI				
Emri i grupit _____		Vlerësuesi _____		
Pjesëmarrësit e grupit				
6. _____				
7. _____				
8. _____				
9. _____				
10. _____				
Kategoritë e vlerësimit	Pikët e mundshme	Pikët e marra		
	maksimum	Riciklim	Veshje	Total
KREATIVITETI	20			
ORIGJINALITETI	15			
RELEVANCA ME TEMËN	10			
PRAKTICITETI	10			
PËRDORIMI I MATERIALEVE & PROCEDURA	15			
CILËSIA E DIZEJNIMIT	10			

PUNA NË GRUP	10			
INSPIRIMI	10			
Pikë total				

Referenca

<http://www.theliberty.co.uk/wp-content/uploads/2016/03/The-Liberty-Fashion-Design-Competition-2016-TCs-and-Guidelines.pdf>

https://www.aec.org/page/iaedc_judge_criteria

http://www.fashiondesignerawards.com.pl/pliki/Regulamin_FDA_2018_en.pdf

<https://www.wikihow.com/Prepare-a-Fashion-Design-Portfolio>

<https://1.cdn.edl.io/gvmxx8ohRza00DRdcPZpU99DkEwxqsvqPeGZPdJiYSKtqfMO.pdf>

Organizimi i Eventit Startup

Ky është një udhëzues për zhvillimin e një Konkursi mësimor, gjatë javës së praktikave profesionale, për nxënësit e shkollës Hamdi Bushati në lëndën e “Sipërmarrjes”. Aktiviteti përfshin një grup nxënësish që kanë një ide biznesi të përpunuar dhe menduar më përpara ose mund t’i lindë gjatë aktivitetit. Grupet e punës mund të jenë krijuara ose pritet që të krijohen. Propozohet që të nxënësit e klasave të 10 të punojnë me nxënës të tjerë më me eksperiencë. Ata pritet që gjatë ditës së aktivitetit të formësojnë idenë e biznesit më të gjithë elementet e nevojshëm, të cilat e bëjnë atë një ide tërheqëse, inovatore dhe në interes të komunitetit. Gjithashtu, do të bëhet e mundur edhe ideimi i planit të biznesit për këtë ide me ndihmëm e mentorimit nga ekspertë të ftuar dhe mësues të lëndës.

Lëndët/modulet që integrohen:

Qëllimi mësimor:

Qëllimi afektiv:

Objektivat:

RM-të që do të arrihen:

Metoda që do të përdoret: Konkursi mësimor

Koha e realizimit: X orë mësimore, ose një ditë mësimore

Pjesëmarrësit: klasat dhe numri i nxënësve (nxënës që do të jenë në skuadra dhe nxënës që do të ndjekin konkursin)

Juria: _____

Hapat që do të ndiqen:

- Prezantimi i qëllimit të konkursit mësimor dhe kohës së realizimit nga mësuesi organizator,
- Ndarja e skuadrave dhe përcaktimi i numrit të nxënësve në një skuadër (duke u mbështetur në parapërgatitjen e tyre për veprimtarinë).skuadravemund t’I vendosetdhe një emër ose numër.
- Drejtimi i konkursit, duke përcaktuar detyrën dhe kohën për secilën skuadër.
- Prezantimet hap pas hapi nga liderët e skuadrëve.
- Secila nga skuadrat është në gadishmëri për t’iu përgjigjur pyetjeve që mund t’I bëhen nga anaëtarët e jurisë ose pjesëmarrësit (audiencia)
- dhe vënia e pikëve nga juria.
- Shpallja e pikëve totale për secilën skuadër dhe skuadra fituese.
- Përmbyllja e veprimtarisë nga mësuesi organizator.

Si përgatitet një ide biznesi?

Natyra e eventeve që nxisin ide biznesi për stratup, ndihmon për t’i dhënë jetë ideve që individë të ndryshëm mund të kenë. Mirëpo, që ideja të realizohet në mënyrë praktike duhet që të përfshijë disa element kyç dhe duhet të prezantohet në mënyrën dhe strukturën e duhur duke përfshirë çdo element të biznesit. Për këtë qëllim, rekomandohet të përdoret Modeli i Biznesit Canvas. Ky model jep strukturën e plotë të një plani biznesi dhe një menaxhim strategjik për zhvillimin, përmirësimin si dhe dokumentimin e një ideje biznesi.

Modeli i Biznesit Canvas

<p>Partnershipi</p> <p><i>Cfarë partnerësh të duhen dhe si mund ti shfrytëzosh këto partner për të ndërtuar një strategji efikase?</i></p>	<p>Aktiviteti kryesor</p> <p><i>Me çfarë strategjie dhe si do hysh në treg? Pika jote e forte.</i></p>	<p>Krijimi i vlerës</p> <p><i>Cili është elementi që i jep jetë, vlerë propozimit tuaj? Pse klientët kanë nevojë për të?</i></p>	<p>Marrëdhënia me klientët</p> <p><i>Çfarë marrëdhënie apo strategjie do krijosh me klientët dhe si do ndërveproni?</i></p>	<p>Kanalet e komunikimit</p> <p><i>Si do e bësh reklamimin? Si do shesësh? Ku do blesh? Pse? A ia vlen? Funksionon?</i></p>
	<p>Burimet kryesore</p> <p><i>Cilët janë burimet kryesore që të duhen për ndërtuar biznesin tënd?</i></p>		<p>Tregu i synuar dhe klientela</p> <p><i>Kush janë klientët? Çfarë duan? Cili është problemi? Çfarë shohin, vlerësojnë, ndjejnë? Zgjidh tregun e synuar dhe mblidh sa më shumë informacione</i></p>	
<p>Struktura e kostove</p> <p><i>Cfarë kostosh ka biznesi? Gjërat kryesore që të duhen dhe si lidhen këto të fundit me fitimin</i></p>		<p>Burimet e fitimit</p> <p><i>Si do të gjenerohen të ardhurat në këtë biznes? Mënyrat e fitimit</i></p>		

Organizimi i eventeve për startup

Gjatë ditës së aktivitetit të gjithë grupet pjesëmarrëse në eventin për startup duhet të përgatiten për të prezantuar në mënyrë të artikuluar qartë dhe me detajet e nevojshme idenë e tyre. Aktiviteti mund të zhvillohet sipas hapave të mëposhtëm:

Hapat	Koha	Çfarë?	Personi përgjegjës
Pjesa 1	09:00 - 10:00	60'	
		<ul style="list-style-type: none">• Prezantimi i rregullave të startup-it• Objektivat e eventit• Fjalim motivues	•
Hapja			
	09:00 - 09:20	20'	
		<ul style="list-style-type: none">• Ndarja e nxënësve sipas grupeve të punës, diskutimi dhe qartësimi i ideve• Prezantimi i të gjitha ideve pjesëmarrëse me një kohë 3 minuta për grup. <i>Rregulli i çdo prezantimi: Çfarë ideje është? Kujt i shërben? Kush janë klientët? Si do të realizohet produkti apo shërbimi?</i>	•
Pjesa 2	09:20 - 13:00	220'	
Mentorimi dhe input mbi idetë e prezantuara		<ul style="list-style-type: none">• Mentorimi i grupeve të punës nga ekspertë të shkrimit të planit biznesit sipas Modelit të Canvas• Diskutimi dhe përmisimi i ideve të krijuara• Input dhe feedback mbi realizimin dhe përsosjen e idesë dhe planit të biznesit	•
Pjesa 3	13:00 - 13:20	20'	
Përgatitja dhe prezantimet finale		<ul style="list-style-type: none">• Prezantimi i ideve të finalizuara me planet përkatëse të biznesit• Përcjellja e idesë me të gjitha elementët kyç të nevojshëm për të tërhequr vëmendjen e duhur dhe për të krijuar mundësi më të larta për të fituar <i>Rregulli i çdo prezantimi: 5 minuta prezantim sa më tërheqës</i>	•

Zgjedhja e ideve më të mira

Për përzgjedhjen e fituesve kemi një juri 3 personash e cila vlerëson idetë e prezantuara në bazë të disa kriterëve të përcaktuara. Kriteret lidhen me ndryshimin që do sjellë kjo ide në një fushë të caktuar, realizueshmërinë dhe konceptueshmërinë e kësaj ideje, origjinalitetin, ekzekutimi dhe planin përkatës i marketingut. Forma e vlerësimit që do përdoret nga juria është si më poshtë:

FORMAT VLERËSIMI		
Emri i grupit _____		Vlerësuesi _____
Pjesëmarrësit e grupit		
11. _____		
12. _____		
13. _____		
14. _____		
15. _____		
Kategoritë e vlerësimit	Pikët e mundshme	Pikët e marra
IDEJA	Total 20	
• Vlera e propozimit	5	
• Origjinaliteti, inovacioni	10	
• Ndikimi në zgjidhjen e një problemi	5	
Total për kategorinë 1		
PRODUKTI / SHËRBIMI	Total 20	
• Diferencimi nga konkurrenca ekzistuese	10	
• Identifikimi dhe adresimi i risqeve	10	
Total për kategorinë 2		
PËRGATITJA PËR LANCIM	Total 20	
• Tregu i synuar, identifikimi dhe segmentimi i klientëve	10	
• Modeli i çmimeve	5	
• Parashikimet financiare	5	
Total për kategorinë 3		
PLANI I ZBATIMIT	Total 20	
• Strategjia e marketingut	10	
• Strategjia e shitjes	5	
• Impakti në komunitet	5	
Total për kategorinë 4		
SKUADRA	Total 20	
• Komunikimi në ekip	5	
• Angazhimi dhe motivimi i ekipit	10	
• Strategjia për të tërhequr talente	5	
Total për kategorinë 4		
Pikë total		

Referenca

<https://www.businessnewsdaily.com/6902-business-plan-competitions-entrepreneurs.html>

<http://www.sloansportsconference.com/activities/startup-trade-show-blitz-competition/startup-competition-rules>

<https://www.businessnewsdaily.com/6902-business-plan-competitions-entrepreneurs.html>

<https://mbpc.tcnj.edu/judges/>

<https://startupweekend.org/>

<https://startupweekend.org/attendees/faq>

<https://businessmag.al>

<https://startupweekend.org/>

<https://startupweekend.org/attendees/faq>

<https://entrepreneurship.wharton.upenn.edu/judging-criteria/>

<https://www.nypl.org/help/services/startup/judging-criteria>

<https://www.mipim.com/startup-competition/>

<https://grasshopper.com/blog/startup-competition-guide/>

References:

Jacobsen, A. D, Eggen. P, Kauchak. D, (2006) Methods of teaching, promoting students learning inK-12 classrooms), Pearson, Merrill Prentice Hall, Ohio

Borich, D. G, (2004) Effective Teaching Methods, Pearson, Merrill Prentice Hall, Ohio

Hanushek, E., Schwerdt, G., Woessmann, L., Zhang, L., (2017), “General Education, Vocational Education, and Labor-Market Outcomes over the Lifecycle”, The Journal of Human Resources, (52), 1.


<http://www.akafp.gov.al/wp-content/uploads/2014/09/AKAFPK-Udhezues-per-shkollat-profesionale-2018-191.doc>

<http://dap.gov.al/images/revistat/revista6.pdf>


Annex 2: Steps for matching companies and students for apprenticeships

PRAKTIKAT PROFESIONALE NË BIZNES

15 HAPA




Apprenticeship Model




GSD schemes/ Exposure to the world of work

Open days | Employers' storytelling days | Company visits | Mentoring



⁹ In case of the 2+2 system, the apprenticeships continue in Level III



Involvement of stakeholders

Providers collect demand from businesses for defining no. of enrollments

Parents' active and constant involvement

Stakeholders' platform at regional level

Business relationships management

Pledges

Partners' risk assessment

Mentors' training

MoU (Provider- Company)

Continuous dialogue between providers and companies

Annex 3: Instruments to plan and monitor the implementation of apprenticeships and internships

Instrumentët e Vlerësimit dhe Monitorimit të Praktikës Profesionale në Biznes

Mars 2020

Table of Contents

Praktika profesionale - kuadri ligjor	3
<i>Roli i mësuesit instruktur</i>	4
Zhvillimi gradual i aftësive për punë	4
Puna paraprake për realizimin e PP (Fillimi i mbarë gjysma e punës)	4
<i>Hapat që duhet të ndiqen para hartimit të planit vjetor</i>	5
<i>Hartimi i planeve vjetore mësimore</i>	6
Në varësi të bizneseve me të cilat bashkëpunohet për praktikat profesionale dhe mundësi që ata afrojnë për arritjen e kompetencave të kërkuara, sugjerohet që bashkëpunuesit të hartuar vjetor të hartohet dhe një format analize e mundësi që biznesi kërkon. Modeli I hartuar nga shkolla profesionale “Kolin Gjoka” Lezhë është tepër i përshtatshëm për planifikimin e praktikave në bashkëpunim me bizneset. Këtë format mund ta gjeni Aneks F1.	7
<i>Planifikimi i veprimtarive mësimore/praktike konkrete</i>	7
Hartimi i planit individual të punës në biznes	9
<i>Mënyra e konceptimit të vlerësimit të nxënësve</i>	10
Për vendosjen e vlerësimit përfundimtar (nota)	11
Pikëzimi dhe konvertimi	12
Vlerësimi i nxënësve gjatë praktikës profesionale	13
<i>Pasqyrimi i punës së mësuesit gjatë zhvillimit të praktikave profesionale</i>	15
Aneks	17
Aneks P1. Plani i përgjithshëm i moduleve të praktikës	17
Aneks F1. Format i analizës së moduleve që mund të zhvillohen në kompani për të gjithë bizneset	20
Aneks P2. Plani individual i praktikës	21
Aneks F2. Format i shpërndarjes së nxënësve në kompani	23
Aneks P3. PLAN I MËSUESIT PËR PRAKTIKEN PROFESIONALE	24
Aneks P4. Përmbajtja e praktikës profesionale në biznes	25
Aneks V1. Listë kontrolli e mësuesit – version 1	28
Aneks V1. Listë kontrolli e mësuesit – version 2	29
Aneks V2. Ditar i praktikantit	30
Aneks PV3. Fletë vlerësimi nga mentori për module/RM	31

Aneks V4. Vlerësim përfundimtar nga mentori	32
ANEKS V5. Format vetëraportimi nga nxënësi për zhvillimin e punës në biznes	36
ANEKS V4. Model për përmbajtjen e praktikës në biznes	37
ANEKS PV1. Plani individual i punës në biznes/ fletëvlerësimi	39
ANKES P2. Model plan ditari për veprimtari të ndryshme mësimore	40
Aneksi V7. Fletë pune për nxënësin 1	42
Aneks 8. Fletë pune 2: Pritshmëritë e mia	43
Aneks V9. Fletë pune 3	43
Aneks P7. Plan mësimor: Bisedë me një profesionist	44
Aneks V10. Fletë pune 1	46
Aneks V8. Model plan ditar për orë që realizohen në mjediset e shkollës	48

Praktika profesionale në funksion të zhvillimit gradual të aftësive për punë të nxënësve

Praktika profesionale - kuadri ligjor

Programet e mësimdhënies së moduleve të praktikës profesionale, hartohen nga instruktorët përkatës, bazuar në "përshkruesit e moduleve profesionale" përkatëse (të përfshira në skeletkurrikul), dhe mund të realizohen në mjediset e praktikave të shkollës ose në biznese/ndërmarrje. Skeletkurrikuli nuk përcakton pjesën e praktikës profesionale si dhe modulet (ose RM-të e tyre) që duhet të realizohen në mjediset praktike të shkollës apo në mjediset e bizneseve/ndërmarrjeve. Është vetë shkolla që e përcakton pjesën e praktikës profesionale që do të kryhet në biznes, nisur nga mundësitë konkrete dhe marrëveshjet me bizneset në rajonin përkatës. Shkolla ka pavarësi të plotë në renditjen dhe orarin e trajtimit të moduleve praktike, sigurisht

duke konsideruar dhe faktorë të tjerë si: parimet didaktike, varësinë logjike të moduleve, etj.

Roli i mësuesit instruktor

Mësuesi i praktikës (shkolla) ka pavarësi për të përcaktuar kohëzgjatjen e çdo RM-je si dhe për të detajuar "veprimtaritë mësimore, kohët, vendin e realizimit si dhe kërkesat për realizimin" e RM-së përkatëse".

Në "programin e mësimdhënies së modulit", në përputhje me natyrën e modulit profesional, brenda kohëzgjatjes së RM-ve, mund të parashikohen veprimtari mësimore që tregojnë ato çka kryen si mësuesi i praktikës, ashtu edhe nxënësit (p.sh., rikujtim i aspekteve teorike, përgatitje e vendit të punës, demonstrim i një procesi pune nga instruktori, praktikim i mbikqyrur ose i pavavrur, i një procesi pune nga nxënësit, provim praktik i nxënësve, vizitë mësimore, praktikë shtesë për modulet ose RM-të që nuk janë arritur nga nxënësit e prapambetur etj). (Udhëzues për mësuesit e drejtuesit e shkollave profesionale, AKAFPK,2018)

Zhvillimi gradual i aftësive për punë

Zhvillimi gradual i aftësive për punë të nxënësit kërkon një planifikim të kujdesshëm dhe një vlerësim sistematik të praktikës nga ana e mësuesit. Prandaj, për të realizuar sa më mirë qëllimin e praktikave profesionale, duke u mbështetur në Udhëzuesit e AKAFPK -së dhe eksperiencës së shkollave partnere në zhvillimin e praktikave profesionale, si dhe pilotimit gjatë këtij viti shkollor të instrumentave planifikuese e vlerësuese, në këtë material paraqiten modele të planifikimit e vlerësimit të praktikës profesionale dhe udhëzime të hollësishme për realizimin sa më të mirë të zhvillimit gradual të aftësive për punë të nxënësve.

Udhëzimet e mëposhtme për planifikimin dhe vlerësimin e praktikave në biznes, i vijnë në ndihmë mësuesve të PP dhe drejtuesve të shkollave për të realizuar PP në biznes në mënyrë sa më efçente e në funksion të ZHGAP -it.

Puna paraprake për realizimin e PP (Fillimi i mbarë gjysma e punës)

Që në fillim të vitit shkollor çdo mësues i praktikës profesionale duhet t'i bëjë vetes pyetjen: - *Çfarë do të arrijnë nxënësit e mi në praktikën profesionale, për çfarë do të shërbejë praktika profesionale?*

Sigurisht që për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetje çdo mësues duhet të njohë shumë mirë kurrikulat e lëndës që ai mbulon, mundësitë që ofron shkolla për realizimin e praktikave profesionale, mundësitë që japin bizneset e zonës për zhvillimin e praktikave profesionale, si dhe njohuritë që nxënësi ka nga ana teorike për lëndën, pa anashkaluar parimet psiko- pedagogjike për të nxënë të mësimit.

Për këtë që para fillimit të vitit shkollor mësuesit duhet të planifikojnë mënyrën sesi do zhvillohen modulet, duke patur të qartë qëllimin që duhet të arrijnë. Funkcioni i qëllimeve në këtë nivel, si në aspektin filozofik ashtu dhe në atë konceptual është që të japin drejtimin e përgjithshëm, përse i përket asaj se çfarë duhet të dinë nxënësit dhe çfarë kompetencash duhet të fitojnë (njohuri, shkathtësi, qëndrime) gjatë praktikës profesionale.

Vendimet përse i përket zhvillimit të qëllimeve afatgjata kërkojnë që mësuesi të përcaktojë rezultatet e të nxënës në një rrugë të përgjithshme. Një ndihmë për këtë sigurisht janë udhëzuesit kurrikularë të AKAFP-së, por përgjegjësia e mësuesit është që të fokusohet në rrugë në të cilat nxënësit do të zhvillojnë aftësinë e tyre për profesionin për të cilin ata po specializohen.

Hapat që duhet të ndiqen para hartimit të planit vjetor

Për hartimin e planifikimit vjetor të praktikave profesionale nuk mjafton thjesht të kopjosh programet e dhëna në udhëzuesit kurrikularë të AKAFP. Një punë paraprake është e nevojshme me qëllim që realizimi i praktikës profesionale mos i lihet spontaneitetit apo shablloneve të dhëna, të cilat nuk funksionojnë njësoj në të gjitha shkollat. Për këtë sygjerohet:

- a. Analizë e punës së bërë një vit më parë për praktikën në biznes, duke evidentuar se si është realizuar procesi, problematika e përparësi të bashkëpunimeve me biznese të ndryshme gjatë zhvillimit të praktikës profesionale.
- b. Analizë e përmbajtjes dhe përshtatshmërisë së saj me kurrikulat, evidentim i kompetencave profesionale që janë arritur në biznes dhe në shkollë gjatë zhvillimit të PP.

- c. Analizë e rezultateve të të nxënësve duke u mbështetur në bashkëpunimin shkollë biznes dhe efikasitetin e instrumenteve të vlerësimit të përdorura.
- d. Së bashku me Njësinë e Zhvillimit të evidentohen bizneset që ofrojnë mundësi për zhvillimin e praktikave profesionale.
- e. Takime me mentorët në biznes për përcaktimin e kompetencave profesionale në të cilat biznesi aftëson nxënësit, dhe atyre që biznesi nuk ka mundësi për t'i realizuar.
- f. Hartimi i planeve vjetore të zhvillimit të praktikës profesionale.

Hartimi i planeve vjetore mësimore

Planifikimi vjetor është tepër i rëndësishëm në zhvillimin e PP. Hapi i parë në planifikim vjetor është të pyesni veten: *"Çfarë dua unë që nxënësit të dinë, të kuptojnë apo të jenë të aftë të bëjnë?"* I gjithë planifikimi juaj, dhe puna juaj me nxënësit rrjedh nga përgjigja e kësaj pyetje. Duke u mbështetur në analizën e detajuar të bërë në punën paraprake, mësuesi në bashkëpunim me Njësinë e Zhvillimit harton planin vjetor të moduleve profesionale që do të zhvillohen në mjediset e shkollës dhe biznesit, në funksion të arritjes së kompetencave të kërkuara nga skelet kurrikula dhe tregu i punës. Ky është një hap i parë shumë i rëndësishëm në planifikimin e strukturuar të praktikës profesionale në funksion të qëllimit të lëndëve/moduleve të praktikës profesionale, nevojave të nxënësve dhe zhvillimit të aftësive për profesionin.

Në bazë të formatit të propozuar nga AKAFPK-së, sygjerohet të shtohen:

- *qëllimet e moduleve & kompetencat e përgjithshme e profesionale që synohet të arrijë nxënësi si rezultat final*
- *Iloji i veprimtarisë si: teori, praktikë në biznes/laborator, vizitë mësimore, vlerësim etj.*
- *shënime që mund të përdoret gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës, ku të shënohen zhvendosjet e temave, apo vendit ku u zhvillua praktika. Kjo rubrikë duhet të pasqyrojë reflektimet e mësuesit gjatë zhvillimit të praktikave profesionale me qëllim që të përmirësojë punën në vitin e ardhshëm.*
- *Përcaktimi i saktë i vendit ku do të realizohet mësimi dhe koha e shprehur në orë mësimore*

Ky plan realizohet në fillim të vitit shkollor nga mësuesi/instruktori përgjegjës në konsultim me Njësinë e Zhvillimit për profilet e bizneseve partnere. Stafi drejtues duhet të mbështesë këtë proces në vijimësi duke shpërndarë në kohë ngarkesat (para fillimit të vitit akademik).

Në hartimin e planeve vjetore sugjerohet që mësuesit të jenë fleksibël dhe të parashikojnë veprimtari mësimore hyrëse, si: vizita në biznes ose të ftuar nga biznesi në klasë dhe veprimtari mësimore përmbyllëse, të tilla, si: ekspozita, panaire, ditë të hapura, ku nxënësit të demonstrojnë aftësitë e tyre. Këto veprimtari do të jenë në funksion qëllimit të modulit, të arritjes së rezultateve të kërkuara mësimore dhe për t'i bërë nxënësit më të motivuar në zhvillimin e praktikës në biznes.

Gjatë hartimit të planit vjetor mësuesi duhet të marrë në konsideratë orët që i nevojiten për veprimtaritë hyrëse apo përmbyllëse të një moduli, pasi këto veprimtari do të llogariten me më shumë se një orë mësimore (siç jepen dhe në modelet e paraqitura). Duke patur parasysh këto veprimtari dhe orët mësimore që do të duhen për realizimin e tyre mësuesit i duhet të llogaritë orët për veprimtaritë mësimore që do të zhvillohen në funksion të realizimit të kompetencave të kërkuara nga kurrikula.

Shembull: Në një modul me 108 orë, 6 orë mësimore planifikohen për vizitë në biznes, dhe 6 orë për konkurs mësimor. Atëherë, do të jenë 96 orë mësimore që do të llogariten për veprimtaritë mësimore sipas RM-ve.

Formati i këtij plani jepet në Aneksin P1. Plani i përgjithshëm i moduleve të praktikës. Në varësi të bizneseve me të cilat bashkëpunohet për praktikat profesionale dhe mundësi që ata afrojnë për arritjen e kompetencave të kërkuara, sugjerohet që bashkangjitur planit vjetor të hartohet dhe një format analize e mundësi që biznesi kërkon. Modeli I hartuar nga shkolla profesionale "Kolin Gjoka" Lezhë është tepër i përshtatshëm për planifikimin e praktikave në bashkëpunim me bizneset. Këtë format mund ta gjeni Aneks F1.

Planifikimi i veprimtarive mësimore/praktike konkrete

Duke e mbështetur në udhëzimet e AKAFP-së, që thotë se në "programin e mësimdhënies së modulit", në përputhje me natyrën e modulit profesional, brenda kohëzgjatjes së RM-ve, mund të parashikohen **veprimtari mësimore** që tregojnë

ato çka kryen si mësuesi i praktikës, ashtu edhe nxënësit (p.sh., rikujtim i aspekteve teorike, përgatitje e vendit të punës, demonstrim i një procesi pune nga instruktori, praktikim i mbikqyrur ose i pavavrur, i një procesi pune nga nxënësit, provim praktik i nxënësve, vizitë mësimore, praktikë shtesë për modulet ose RM-të që nuk janë arritur nga nxënësit e prapambetur etj), planifikimi i moduleve profesionale është menduar që të përfshijë veprimtari hyrëse, si: të ftuar nga biznesi në klasë, vizitë në biznes, dhe veprimtari përmbyllëse, si: konkurse mësimore, ekspozita, projekte mësimore, ditë të hapura, panaire, prezantim i dosjeve, testim, etj.

Në të gjitha këto veprimtari mënyra e organizimit të punës është e mbështetur në qasjen me në qendër nxënësin. Pra, nxënësi nuk është pasiv, vjen me pritshmëri në klasë, nxë në mënyrë aktive dhe ndërton të kuptuarit nëpërmjet të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit, të lexuarit, dhe duke reflektuar rreth përmbajtjes, ideve, çështjeve dhe shqetësimeve. Për të realizuar këtë për secilën nga veprimtaritë mësimore, qofshin këto veprimtari hyrëse, praktikë mësimore ose veprimtari përmbyllëse, nxënësi do të realizojë sa më sipër, duke qenë pjesëmarrës aktiv dhe duke plotësuar fletët e punës dhe shënimet në ditarin e tij, sipas modeleve të dhëna që mund të përshtaten nga çdo mësues në varësi të lëndës, nivelit të nxënësve dhe qëllimit të veprimtarisë që do të zhvillohet.

Këto veprimtari përfshijnë:

- Veprimtari mësimore për prezantimin e nxënësve me qëllimin e modulit dhe realitetin e punës në lidhje me këtë profesion, si vizita në biznes, takim me të ftuar nga biznesi në klasë etj. Këto veprimtari zakonisht duan më shumë së 1 orë mësimore për t'u zhvilluar. Qëllimi i tyre është që të realizohet një të kuptuar më i plotë i profesionit që nxënësit kanë zgjedhur dhe motivimi i nxënësve për praktikën profesionale që do të zhvillojnë në vazhdim. Gjithashtu nëpërmjet organizimit të këtyre veprimtarive sipas modeleve që do t'u sugjerohen mësuesve synohet të realizohet dhe një "vlerësim" i njohurive që nxënësit kanë në lidhje me fushën, si dhe të nxitet të nxënësit aktiv e të menduarit kritik e krijues. Realizimi i këtyre veprimtarive krahas qëllimit mësimor (njohja me profesionin e procedurat e punës) ka si qëllim dhe realizimin e kompetencave të përgjithshme të kërkuara nga kurrikula e AP dhe motivimin e nxënësve.

Një model planifikimi të këtyre orëve jepet në aneksin **P5. Plane ditar për veprimtari mësimore**

- Veprimtari nga mësuesi për sistemimin dhe vlefshmërinë e njohurive që nxënësit kanë në lidhje me fushën si diskutime e ndarje njohurish mes nxënësve/praktikantë, quice, konkurse, etj. Të tilla veprimtari mund të zhvillohen në 1 ose 2 orë mësimore dhe rezultatet mund të përdoren nga mësuesit si referencë për mentorin në lidhje me njohuritë teorike që nxënësi ka për modulën që do të zhvillojë në praktikë.
- Veprimtari mësimore për vlerësimin e kompetencave të arritura gjatë një moduli të zhvilluar. Këto veprimtari mund të zhvillohen përgjatë zhvillimit të modulit në praktikë. Mësuesi me anë të listave të kontrollit që do të përdorë gjatë vëzhgimeve të punës në biznes mat arritjet e nxënësve gjatë zhvillimit të praktikës. V1. Listë kontrolli për vlerësimin e punës në biznes (për mësuesin)

Veprimtari mësimore në fund të zhvillimit të praktikës, të tilla si: ekspozita, panairë, ditë të hapura, konkurse mësimore. Në fund të praktikave mësimore për një modul, ose grup modulesh është e rëndësishme të zhvillohet një veprimtari përmbyllëse që ka si qëllim vlerësimin e nxënësve për punën e zhvilluar. Në këto veprimtari mësuesit do t'i duhet të sigurojë një sërë instrumetash matëse për një vlerësim sa më të plotë e të saktë të nxënësve në të treja fushat: *konjitive, psikomotore e afektive*.

E rëndësishme është që mësuesi që në fillim të vitit shkollor të planifikojë:

- Veprimtaritë që do të zhvillohen në mjediset e praktikës në shkollë.
- Veprimtari që zhvillohen në biznes.

Sugjerohet që mësuesi të ndërtojë kombinimin më të mirë të këtyre veprimtarive, sipas kushteve dhe qëllimit. P.sh në rastin e klasave të 10-a, veprimtaritë paraprake të njohjes me profesionin zënë një rol të rëndësishëm në muajt e parë, ndërsa në klasat e 12-a, pjesa dërrmuese e praktikës zhvillohet në biznes.

[Hartimi i planit individual të punës në biznes](#)

Hartimi i kujdesshëm i planit vjetor të Moduleve të praktikës profesionale, është një ndihmë e madhe për mësuesit në Hartimin e planeve individuale për secilin nxënës në biznes.

Në aneksin **P2 plani individual i praktikës profesionale**, jepet modeli i planit individual të punës në biznes për secilin nxënës, në të cilin shënohen periudhat, për secilën nga veprimtaritë që do të zhvillojë nxënësi gjatë kësaj periudhe. Njohja e mentorëve me këtë plan ndihmon dhe në përcaktimin e saktë të periudhave në të cilat nxënësi do të jetë në biznes ose në shkollë, duke bërë të mundur dhe hartimin e kontratave më fleksibël.

Gjithashtu në bashkëpunim me biznesin hartohet një format me kompetencat profesionale dhe të përgjithshme që nxënësi duhet të fitojë gjatë zhvillimit të praktikës në biznes. Ky format shërben dhe si fletë vlerësimi për nxënësin nga mentori. Ky model jepet në aneks **PV1. Format për mentorin**.

Ky plan duhet të hartohet bashkë me mentorët në biznes, të cilët duhet të dakordësojnë për modulet që mund të zhvillohen në biznes. Propozohet që përmbajtja e moduleve (RM) që zhvillohen në biznes të shoqërojë planin dhe të diskutohet me mentorin në mënyrë që saktësohen pritshmëritë nga kjo praktikë. Gjatë vizitave periodike, mentori dhe mësuesi i praktikës duhet të diskutojnë mbi nivelin e arritjeve të nxënësve sipas treguesve të formatit të përgatitur nga mësuesi dhe aftësive që nxënësi realizon në praktikë.

Për të patur një pasqyrë të qartë të shpërndarjes së nxënësve mund të përdoret formati F2 në aneks, I përdorur nga mësuesit e shkollës "Kolin Gjoka" Lezhë.

Mënyra e konceptimit të vlerësimit të nxënësve

Roli i mësuesit në zhvillimin e moduleve profesionale në praktikë është parësor si në planifikimin e veprimtarive dhe realizimin e tyre në funksion të qëllimit të modulit, por dhe në vlerësimin e nxënësve për arritjen e kompetencave të kërkuara nga kurrikula.

Duke patur parasysh që *Kompetenca është e vlerësueshme përmes analizës për evidentimin e mospërputhjes midis aftësive të kërkuara dhe aftësive të përdorura në vendin e punës*, për mësuesit sugjerohet të përdoret një listë kontrolli me arritjet e nxënësve për çdo RM, duke u mbështetur në kriteret e vlerësimit të pasqyruara në

kurrikul, sepse RM-të, instrumentet dhe kriteret e vlerësimit të nxënësve janë **detyruese** (pra, nuk mund të ndryshohen nga shkolla).

Për të ndjekur ecurinë e nxënësve gjatë zhvillimit të praktikës profesionale mësuesi duhet të përcaktojë se cilat rezultate të nxënësve duhen marrë në konsideratë për përshkrimin e drejtimit profesional apo profilit përkatës së kualifikimit.

Plotësimi i listave të kontrollit gjatë vëzhgimeve të punës në biznes i bashkërenduar me konsultimet me instruktorët në praktikë bën të mundur vlerësimin e rezultateve të të nxënësve (RM) në mënyrë më reale.

Për vendosjen e vlerësimit përfundimtar (nota)

Duke u mbështetur në udhëzuesit kurrikularë të AP:

1. Nxënësi duhet të ketë vlerësim me notë në çdo modul praktik profesional, për çdo Rezultat Mësimor (RM), ndaj duhet të vlerësohet gjatë dhe në fund të periudhës që i përket përmbushjes së një RM-je.
2. *Nëse praktika zhvillohet në biznes, vlerësimi ndodh në fund¹, aspekt për t'u pasur në konsideratë gjatë hartimit të planit dhe plotësimit të regjistrimit.*

Vlerësimi përfundimtar do të realizohet duke u mbështetur në 3 vlerësime:

1. Vlerësimi i bërë nga mentori në biznes
2. Vlerësimi i bërë nga instruktori (mësuesi i praktikës)
3. Vetëvlerësimi i nxënësit për praktikën e zhvilluar në biznes.

Për të realizuar këto vlerësime sugjerohen këto instrumente:

- a) Ditari i nxënësit, i cili do të mbahet për çdo ditë praktike. Sugjerohet që ky ditar të kontrollohet periodikisht dhe të pasurohet me materiale audiovizuale. Modeli në aneksin V2.
- b) Vëzhgimet me listë kontrolli nga mësuesi, të realizuara nga mësuesi në ditët e vëzhgimit në biznes (të cilat duhet të jenë të planifikuara në një grafik të

¹ Udhezues i AKFP per 2018-2019, f.7 “Për praktikën profesionale në ndërmarrje/biznes, në bashkëpunim me biznesin, nxënësi vlerësohet nga instruktori i shkollës në fund të realizimit të kësaj praktike”

hartuar nga vetë mësuesi). Mësuesi mund të diskutojë me mentorin për një plotësim më të saktë të performancës së nxënësit. Modeli në aneksin V1.

- c) Vlerësimi i mentorit për modulet/RM në biznes sipas formatit të dhënë nga mësuesi. Ky si rregull plotësohet në fund të vitit. Propozohet që mentori ta diskutojë këtë vlerësim me praktikantin, i cili do e firmosë në fund. Modeli në aneksin PV1.
- d) Fletët e punës për veprimtaritë me njohjen e modulit (vizita, etj) dhe për veprimtaritë mbyllëse (që mund të përfshijnë vlerësime për punë me projekte, panaire, konkurse mësimore, ekspozita). Modelet për këto fletë pune të cilat do të jenë pjesë e dosjes së nxënësve dhe janë pjesë e modeleve të orëve të planifikuara për veprimtari hyrëse ose përmbyllëse të PP.

Për vlerësimin e modulit, sipas veprimtarive të kryera në lidhje me programin, mësuesit mund të përfshijnë edhe:

1. *diskutime në klasë ku nxënësit shfaqin dhe video e ndajnë me njëri tjetrin çfarë kanë mësuar (skeda e vëzhgimit mund të përdoret si instrument matës për këto veprimtari)*
2. *miniprojekt që realizohet në biznes/laborator dhe vlerësohet nga mjeshtri dhe/ose mësuesi;*
3. *veprimtari në grup si: konkurse, panaire, ditë të hapura, etj.*

Pikëzimi dhe konvertimi

Përsa i përket vlerësimit përfundimtar, duke u mbështetur në udhëzuesit e AKAFP-së për AP, nota për modulën llogaritet si mesatare e thjeshtë e vlerësimeve për çdo RM.

Në listat e kontrollit dhe fletën e planit individual të biznesit që shërben dhe për vlerësimin e nxënësve në biznes për RM-të, është vënë pikëzimi nga 1-5, ku:

- ❖ 5 - **Shkëlqyeshëm**, përmbush të gjitha standardet.
- ❖ 4 - **Shumë mirë**, përmbush shumicën e standardeve.
- ❖ 3 - **Mirë**, përmbush disa standarde.
- ❖ 2 - **Mjaftueshëm**, përmbush pak standarde.

❖ 1 - **Dobët**, nuk përmbush asnjë standard.

Për llogaritjen e vlerësimit përfundimtar duke u mbështetur në këtë vlerësim për çdo RM nga mësuesi mentor dhe instruktori, meqë numri total i vlerësimeve është i ndryshëm nga moduli në modul, pikët përfundimtare do të llogariten si mesatare e thjeshtë matematike: shuma totale e pikëve/ numrin total të vlerësimeve. Për konvertimin e pikëve në notë mund të përdoret tabela e mëposhtme, në të cilën me 40% e pikëve nxënësi konsiderohet ngelës, dhe intervalet nga nota në notë 10%.

Mesatarja e pikëve në total	0 -1,4	1,5 - 2	2,1-2,6	2,7-3,2	3,3 -3,8	3,9-4,4	4,5-5
%	40%	10%	10%	10%	10%	10%	10%
Nota	4	5	6	7	8	9	10

Në modelin e dhënë për mësuesit për listën e kontrollit janë vendosur dhe rezultate të të nxënësve për kompetencat e përgjithshme. Edhe këto mund të merren parasysh në vlerësimin përfundimtar të nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve gjatë praktikës profesionale

Udhëzime për mënyrën e realizimit të vlerësimit.

Nota përfundimtare e modulit të praktikës profesionale në biznes do të jetë shuma e 3 vlerësimeve të mëposhtme, e ndarë në %.

V1 – vlerësimi nga mentori 40%

V2 - vlerësimi nga mësuesi 40%

V3 - vlerësimi i dosjes (vetëvlerësimi) - ditari i nxënësit + fletët e punës në dosje, vlerësim për projekte, ekspozita ose veprimtari përmblyëse 20%

$$\text{Nota përfundimtare} = (V1 \times 0.4) + (V2 \times 0.2) + (V4 \times 0.4)$$

Kjo formulë është në përputhje me udhëzuesit për vlerësimin e nxënësve në AML:

1. Për listat e kontrollit nga mësuesi konvertimi bëhet në varësi të RM-ve, për të cilat nxënësi është vëzhguar në biznes ose në mjediset e shkollës ku janë realizuar këto RM.

Psh:

RM 1	RM 2	RM 3	RM 4	RM 5	RM 6	RM 7	RM 8	RM 9	Pikë total
5	4	3	5	2	5	4	4	3	3.3

Mesatarja e pikëve në total	0 -1,4	1,5- 2	2,1- 2,6	2,7-3,2	3,3 - 3,8	3,9-4,4	4,5-5		
Nota	4	5	6	7	8	9	10		

2. Në fletën e vlerësimit të mentorit për çdo RM mund të përdoret e njëjta formulë.

RM 1	RM 2	RM 3	RM 4	RM 5	RM 6	RM 7	RM 8	RM 9	Pikë total
4	4	4	5	3	5	4	4	4	37/9-4.1

Mesatarja e pikëve në total	1-1,2	1,3- 2	2,1-2,9	3-3,6	3,7-4,4	4,5-4,9	5		
Nota	4	5	6	7	8	9	10		

Mesatarja e pikëve në total	0 -1,4	1,5- 2	2,1- 2,6	2,7-3,2	3,3 - 3,8	3,9-4,4	4,5-5		
Nota	4	5	6	7	8	9	10		

3. Për vetëvlerësimin.

Në bazë të fletëve të ditarit të plotësuar, nxënësi mund të japë në fund një vlerësim me notë për veten, ose mund të prezantojë para shokëve dhe vlerësimi të kryhet nga vetë nxënësit për njëri - tjetrin me notë, ndërkohë që mungesa e fletëve të ditarit të penalizohet me ulje pikësh. Për projektin, vlerësimi mund të jetë për grup nxënësish, sepse zakonisht projektet realizohen në grup.

Kriteret e vlerësimit për projektin ose veprimtarinë përmbyllesë, do të jenë sipas rubrikave (me poshtë jepet një model), por mund të ndryshojnë në varësi të veprimtarisë.

Format vlerësimi për punën me projekte

Bashkëpunimi	Produkti	Respektimi i rregullave teknike	Prezantimi	Totali
4	5	5	4	18/4- 4,5

Konvertimi për vlerësimin e punës me projekte

Nota përfundimtare= $(V1 \times 0.4) + (V2 \times 0.2) + (V4 \times 0.4)$

$8 \times 0.4 + 9 \times 0.2 + 9 \times 0.1 + 9 \times 0.4 = 3,2 + 1,8 + 3,6 = 8,6 \rightarrow$ e rrumbullakosur **9**.

Për vlerësimin përfundimtar të nxënësve sugjerohet që mësuesit të vendosin të dhënat në database excel.

Pasqyrimi i punës së mësuesit gjatë zhvillimit të praktikave profesionale

Zhvillimi i praktikës profesionale në biznes shpesh mund të sjellë ngarkesë për mësuesin dhe vështirësi në organizimin e monitorimin e punës. Për këtë një instrument i rëndësishëm në të gjithë punën planifikuese dhe vlerësuese të mësuesit për praktikën profesionale është dhe hartimi i një skede mujore për të pasqyruar punën konkrete të mësuesit në funksion të realizimit të praktikës profesionale. Format i për këtë jepet në aneks **P3**.

Realizimi i temave mësimore të planifikuara në modul jo gjithmonë ka mundësi të zhvillohen në biznes, prandaj që në hartimin e planit vjetor të PP dhe hartimin e planit individual të nxënësve mësuesi përcakton RM-të që do të zhvillohen në mjediset e shkollës dhe periudhën e zhvillimit të tyre.

Për secilën nga orët mësimore që zhvillohet në mjediset e shkollës mësuesi duhet të jetë i përgatitur prapakisht me një plan ditor ku të përshkruhen elementët kryesorë të një ore mësimore, si: qëllimi i orës, veprimtaritë mësimore, metodat e përdorura dhe mënyra e vlerësimit.

Si model për këtë mund të shërbejë plani ditor i paraqitur në aneksin **P 6**.

Referenca

[http:// www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/udhezues/](http://www.akafp.gov.al/dokumente-kurrikulare/udhezues/)

<http://www.akafp.gov.al/ëp->

[content/uploads/2014/09/20100205075424_udhezues_per_hartimin_e_kurrikulave
_te_afp_ne_shqiperi1.pdf](http://www.akafp.gov.al/content/uploads/2014/09/20100205075424_udhezues_per_hartimin_e_kurrikulave_te_afp_ne_shqiperi1.pdf)

Anekse

Aneks P1. Plani i përgjithshëm i moduleve të praktikës

Shkolla

Viti shkollor

Drejtimi/Profili profesional....., Niveli

Klasa

Mësues/e:

Programi i mësimdhënies të Moduleve Profesionale

Kompetenca të përgjithshme	Kompetenca Profesionale
-...	-...
-...	-...

Moduli xxx Kodi: M-xxx Orë mësimore xxx

Periudha e zhvillimit: shtator-dhjetor 2018

Qëllimi: _____

Nr	Rezultatet mësimore / Periudha	Veprimtaritë mësimore	Koha	Lloji i veprimtarisë	Instrumente të vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin	Shënime
RM1	Nxënësi përdor mjetet e pajisjet në kuzhinë 12 orë mësimore 11 orë veprimtari 1 orë vlerësim	Njohuri mbi mjetet e pajisjet ne kuzhine, përdorimi e funksioni i tyre .	1 orë	Demontrime në laborator/luzhinë	Listë kontrolli Ditar i nxënësit	Klasë	Pajisje pune që përdoren në kuzhinë. Kabinet kuzhine reale Perime të freskëta	Muaji Shtator
		Demonstrim për mjetet e pajisjet që përdoren në kuzhinë.	1 orë			Kabinet Kuzhine		
		Njohuri mbi mprehjen e thikave e përdorimin e rendes. Demonstrim.	1 orë			Kabinet		
		Njohje me mjete e pajisje pune që përdoren në kuzhina reale.	3 orë			Biznes		
	Vlerësim RM 1	1 orë	Vlerësim	Vëzhgim me listë kontrolli .	Kabinet kuzhine			
RM2	Nxënësi parapërgatit perimet e frutat për gatim. (24 orë mësimore)	1.Proceset parapërgatitore të gatimit të perimeve në kuzhinë. -Demonstrim - praktikim.	1 orë	Praktikë ne biznes	Vëzhgim	Klase	Komplete mjetesh e pajisje kuzhine: për prerjen e perimeve. Perime të freskëta	Muaji Tetor
		2.Teknikat e prerjes së qepës, patates , karotës në formë	1 orë	Praktikë në biznes		Kabinet Kuzhine		

		fije,rondeleje, kubike, zhulienn, gjysme rrathë.Demostrim,						

Moduli _____ **Kodi: M-**_____ **Orë mësimore** _____

Periudha e zhvillimit: Janar- shkurt (viti)

Qëllimi: _____

Nr	Rezultatet mësimore /Kohëzgjatja	Veprimtaritë mësimore	Koha	Lloji i veprimtarisë	Instrumente të vlerësimit	Vendi	Kërkesa për realizimin	Shënime

Aneks F1. Format i analizës së moduleve që mund të zhvillohen në kompani për të gjithë bizneset

Format i analizës së moduleve që mund të zhvillohen në kompani për të gjithë bizneset

Drejtimi	Viti	Profili	Modulet	Kompania											
				ARA Restorant	GOGA Fish	RAPSODIA	HOTELI I GJUETISE	Taverna ENVI	PRINC Adriatik	AMADEOS Piceri	LISS 2	ADRIATIK I VJETËR	BIANCO TRADE	VILA VENETO	BAR KRISTI
Hoteleri-Turizëm	X	Përgjithshëm	"Kuzhinë" - 108 orë	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
			"Shërbime në restorant" - 108 orë	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po
			"Shërbime në Reception" -36 orë	Jo	Jo	Po	Po	Jo	Po	Jo	Po	Jo	Jo	Po	Jo
			"Shërbime Pastrimi 1" - 36 orë	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po	Po

Aneks P2. Plani individual i praktikës

PLAN INDIVIDUAL I PRAKTIKËS PROFESIONALE

Emër Mbiemër: _____

Drejtimi Profesional, Profili: _____

Klasa: _____

Viti shkollor _____

Biznesi: _____

Mentori: _____

Viti 1^{re} i praktikës profesionale

Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht

Legjenda

	Modul i zhvilluar në biznes
	Vlerësim me listë kontrolli nga mësuesi
	Verifikim i vetraportimeve nga nxënësit
	Veprimtari tjera vlerësuese (konkurs, projekt, prezantime, etj)
	Feedback final i mentorit
	Përgatitja dhe provim final
	Pushime nga shkolla
	Plotësim i orëve të praktikës
	Praktikë gjatë verës

Viti 2^{të} i praktikës profesionale

Shtator	tetor	nëntor	Dhjetor	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht
Kuzhinë e pasticeri											
Shërbime në restorant dhe bar											
			Sh. në Reception								
					Sh. Pastrimi						
						Modul me zgjedhje					

Legjenda

	Modul i zhvilluar në biznes
	Vlerësim me listë kontrolli nga mësuesi
	Verifikim i vetraportimeve nga nxënësit
	Veprimtari tjera vlerësuese (konkurs, projekt, prezantime etj)
	Feedback final i mentorit
	Përgatitja dhe provim final
	Pushime nga shkolla
	Plotësim i orëve të praktikës
	Praktikë gjatë verës

Aneks F2. Format i shpërndarjes së nxënësve në kompani

Kompania ARA restorant	Drejtimi	Klasa	DITA	Nxënësi	Kontakte te Nxenesve	Shënime nga kompania
		XA	E Enjte	Dena Bushati		
		XA	E Enjte	Dena Bushati		
Modulet:		XA	E Enjte	Dena Bushati		
		XB	E Premte	Ana Fusha	698264XXX	
		XB	E Premte	Ana Fusha	699905XXX	
Kuzhinë - 108 orë		XB	E Premte	Ana Fusha	697596XXX	
Shërbime në Restorant - 108 orë		XB	E Premte	Ana Fusha	695776XXX	
Shërbime Pastrimi 1 - 36 orë	Hoteleri- Turizëm	XC	E Marte	Mark Buçpapa	682606XXX	
		XC	E Marte	Mark Buçpapa	698168XXX	
		XC	E Marte	Mark Buçpapa	699175XXX	
Mesuesit e praktikës:				Mentor i Praktikës:		
Ariana Poni & Blerta Toma (klasa XB & XC)				Mariana Nikleka / 069XXXXXX		
Afrim Dule & Mara Mali (Klasa XA)						

Aneks P3. PLAN I MËSUESIT PËR PRAKTIKEN PROFESIONALE

Mësuesi _____

Drejtimi _____

Klasa _____

Lënda _____

Muaji _____

Vendi	Java/veprimtaria				
	Java 1	Java 2	Java 3	Java 3	Java 4
Biznes		Vëzhgim (Emri i biznesit)	Vëzhgim (Emri i biznesit)	Vëzhgim (Emri i biznesit)	
Shkollë					Prezantim I dosjeve
Shkollë	I ftuar në klasë				

Aneks P4. Përmbajtja e praktikës profesionale në biznes

Viti	Moduli	Posti i punës	Kompetenca profesionale/RM Në përfundim të praktikës është i/e aftë të:	Kompetenca personale
I parë	Kuzhinë	Kuzhinë	<ul style="list-style-type: none"> - përdor mjetet dhe pajisjet kryesore në kuzhinë - parapërgatit perimet dhe frutat për gatim - përgatit vezë të ziera, "poshe", "syze", omletë - përgatit buljon të zakonshëm; buljon/supë me perime/pulë/krem. 	<ul style="list-style-type: none"> - Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme - Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional. - Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente. - Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në
	Restorant	Restorant	<ul style="list-style-type: none"> - zbaton rregullat e qëndrimit dhe sjelljes në restorant - zbaton rregullat e sigurisë në punë dhe të dhënies së ndihmës së pare - mirëmban sallat, mjedise të tjera dhe pajisje të restorantit - mirëmban mjetet e shërbimit në restorant - shtron sallën e restorantit për shërbimin "A la carte" - parapërgatit sallën për shërbimin e drekës dhe darkës. - kryen shërbime të thjeshta të pijeve dhe ushqimeve në restorant 	
	Reception	Reception	<ul style="list-style-type: none"> - zbaton rregullat e shërbimit në reception - përdor mjetet dhe pajisjet në reception - shoqëron klientin në dhomë 	
I dytë	Kuzhinë e pasticeri	Kuzhinë	<ul style="list-style-type: none"> - përgatit sallata të ndryshme, me perime të ziera dhe të pjekura - përgatit salcë të nxehtë me perime - përgatit salcë majonezë. - përgatit salca të ëmbla. - përgatit brumra me maja, për makarona e byrekë, të zier (brumë shu), sufle - gatuan asortimente me miell misri dhe rizoto - gatuan asortimente të thjeshta me mish - copton dhe gatuan mishin e shpendëve 	

		<ul style="list-style-type: none"> - gatuan prodhime me mish të grirë dhe të brendshme të mishit - përgatit asortimente të thjeshta me peshk, me prodhime deti - përgatit asortimente të thjeshta - përgatit asortimente me perime - përgatit pandispanjë - përgatit kremrat bazë në kuzhinë (caramel, marengje, mousse, pasticer etj.) - përgatit ëmbëlsira të kuzhinës (biskota, komposto, kek etj.) 	<p>kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integritimeve lokale, rajonale.
Shërbime në restorant e bar	Restorant e Bar	<ul style="list-style-type: none"> - parapërgatit dhe shërben mëngjeset - shërben mëngjesin në dhomën e klientit - asiston gjatë shërbimit në restorant me metodave të ndryshme shërbim - përdor e mirëmban pajisjet dhe mjetet e punës në bar (ekspres, lavapjate, gota etj) - përgatit dhe shërben pije të ngrohta (kafe, çaj, cokollate etj) 	<ul style="list-style-type: none"> - Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij. - Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
Shërbime në reception	Reception	<ul style="list-style-type: none"> - kryen rezervime të thjeshta në receptionin e hotelit - kryen rregjistrimin e klientit në receptionin e hotelit (Check In). - kryen ç'rregjistrimin e klientit në receptionin e hotelit (Check Out) - interpreton hartat dhe guidat e qytetit/zonës - këshillon klientin për veprimtari kulturore dhe turistike në zonën e banimit 	<ul style="list-style-type: none"> - Të organizojë drejt, procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
Shërbime pastrimi 2	Lavanderi	<ul style="list-style-type: none"> - pranon, parapërgatit, magazinon dhe dorëzon biankerinë. - kryen procesin e larjes së biankerisë në lavanteri - hekuros biankerinë në lavanteri 	<ul style="list-style-type: none"> - Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e
Përgatitja e një menyje me asortimente të	Kuzhinë	<ul style="list-style-type: none"> - përgatit antipasta dhe supra të zonës me peshk - përgatit pjata kryesore të zonës me peshk - përgatit ëmbëlsira të zonës 	

	zonës me bazë peshku			objektivave të pranuar. – Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.
--	-----------------------------	--	--	---

Aneks V1. Listë kontrolli e mësuesit – version 1

LISTË KONTROLLI PËR MODULET NE BIZNES

Nxënësi _____

Data _____

Drejtimi/Profili _____

Klasa _____

Viti Akademik _____

Biznesi ku bën praktikën _____

Mentori _____

Moduli: _____

RM-ja: Nxënësi identifikon pjesët e mishit sipas ndarjes anatomike të tij

	Gjatë vëzhgimit u vu re që nxënësi:	Vlerësimi ²					Shënime
		1	2	3	4	5	
1	Dallon pjesët sipas ndarjes anatomike të mishit.						
2	Bën ndarjen anatomike të trupit të kafshës sipas llojit						
3	Rendit pjesët e mishit sipas cilëve dhe vendosjes së tyre në trupin e kafshës						
4	emërton pjesët e filetës sipas ndarjes anatomike të saj.						
5	Përlogarit % që zë secila cilësi në peshën bruto të kafshës.						
6	Emërton gjysëmprodhimet që merren nga secila cilësi.						
7	Përshkruan rregullat e ruajtjes, shkrirjes dhe marinimit të mishit.						
8	Etiketon pjesët e ndara të mishit sipas llojit.						
9	Ruan pjesët e ndara të mishit sipas llojit.						
10	Zbaton rregullat e sigurisë, të higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit						
11	<i>Angazhohet në veprimtarinë e tij fizikisht e mendërsiht</i>						
12	<i>Tregon vetëkontroll</i>						
13	<i>Shfaq gadishmërinë e tij për punë</i>						
14	<i>Respekton parimet e punës në grup</i>						
15	<i>Respekton rregullat e higjienës e sigurisë teknike</i>						

² Instruktori mund të vlerësojë me nivele për çdo kriter (5: shkëlqyeshëm; 4: shumë mirë; 3: mirë; 2: mjaftueshëm; 1: dobët) dhe të mbajë shënime për progresin.

Aneks V1. Listë kontrolli e mësuesit – version 2

LISTË KONTROLLI PËR MODULET NE BIZNES

Nxënësi _____
 Drejtimi/Profili _____ Klasa _____ Viti Akademik _____
 Biznesi ku bën praktikën _____ Mentori _____

	Vlerësim i vazhduar ³					
	Datë	Shënime	Datë	Shënime	Datë	Shënime
MODULI KUZHINË						
RM 1. Nxënësi përdor mjetet dhe pajisjet kryesore në kuzhinë						
Të përdorë fetatриçen.						
Të përdorë sfoliatриçen.						
.....						
RM 2. Nxënësi parapërgatit perimet dhe frutat për gatim						
Të veshë uniformën në vendin e punës.						
Të përzgjedhë perimet dhe frutat sipas recepturës.						
.....						
MODULI						
RM..						
.....						
Kompetenca personale						
Respekton parimet e punës në grup						
Respekton rregullat e higjenës e sigurisë teknike						

³ Instruktori mund të vlerësojë me nivele për çdo kriter (5: shkëlqyeshëm; 4: shumë mirë; 3: mirë; 2: mjaftueshëm; 1: dobët) dhe të mbajë shënime për progresin

Aneks V2. Ditar i praktikantit

Në krye të bllokut/fletores shënohet:

Emër Mbiemër _____ Drejtimi/Profili _____ Klasa _____

<p>Data: _____</p> <p>Vendi i praktikës (biznesi ose laborator): _____</p> <p>1. Sot unë jam njohur me:</p> <p>Pajisje</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>Rregulla</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>Procedura</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>2. Gjëja më e veçantë që kam bërë sot është:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>3. Sot unë u ndjeva:</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>.....</p> <p>4. Tjetër:</p> <p>.....</p> <p>.....</p>
--

Nënshkrimi i praktikantit

Data

Nënshkrimi i Instruktorit

Data

Shtojca të raportit (psh: fotografi, një inovacion i prezantuar nga praktikanti/ menu e re, etj.)

Aneks PV3. Fletë vlerësimi nga mentori për module/RM

Emri i instruktorit të biznesit:

Emri i praktikantit:

Periudha e vlerësimit:

Vendi i punës/ moduli	Rezultate të Mësimit praktik	vlerësimi					shënime
		1	2	3	4	5	
kuzhina	Nxënësi identifikon pjesët e mishit sipas ndarjes anatomike të tij.						
	Nxënësi zbaton teknikat e përpunimit të mishrave						
	Nxënësi përgatit buljone me mish/shpendë.						
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me salca shoqëruese						
	Nxënësi përgatit supra						
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me garniturë						
	...						
Restorant	Mirëmban sallat, mjedise të tjera dhe pajisje të restorantit						
	Mirëmban mjetet e shërbimit në restorant						
	Shtron sallën e restorantit për shërbimin "A la carte"						
	...						
Reception	Zbaton rregullat e shërbimit në reception						
	Përdor mjetet dhe pajisjet në reception						
	...						
Shënime të instruktorit për kompetencat e përgjithshme							

Mentori i praktikës: _____

Praktikanti: _____

Data: _____

Data: _____

Aneks V4. Vlerësim përfundimtar nga mentori

Emri i mjeshtrit të biznesit: _____

Emri

i

praktikantit: _____

Periudha e vlerësimit: _____

Njohuria/Kompetenca e përftuar (formular si objektiv për t'u arritur)	Vlerësimi/ Arritja e Objektivit (nga 1 në 5 ⁴)	Komente të tjera nga mbikqyrësi/Çfarë mund të përmirësohet.
Kompetenca Personale		
<p>Komunikimi (Praktikanti ka zhvilluar aftësi të mira komunikuese të nevojave dhe ideve të tij / me kolegët dhe mbikqyrësit në kompani / me klientët)</p> <p>Motivimi (Praktikanti shfaq interes, kuriozitet e angazhim në kryerjen e detyrave, ai zhvillohet në mënyrë aktive në nivel personal në ambientin e punës)</p> <p>Etikë personale dhe profesionale (Praktikanti respekton rregullat e parimet e punës në kompani dhe ndërveprimin me kolegë, mbikqyrës e klientë)</p> <p>Aftësi sipërmarrëse (Praktikanti ndërmerr iniciativa të reja, tregon pavarësi në kryerjen e detyrave etj.)</p> <p>Bashkëpunimi në grup (praktikanti merr pjesë në ndarjen e detyrave në grup dhe bashkëpunimi në grup)</p> <p>Tjetër.</p>		
Kompetenca Profesionale		
Praktikanti ka zhvilluar njohuri mbi organizimin e Bar/Restorantit		

⁴ Sipas instrumentit të shkallëzimit të përshkruar në Tabelën1

Njohuria/Kompetenca e përftuar (formular si objektiv për t'u arritur)	Vlerësimi/ Arritja e Objektivit (nga 1 në 5 ⁴)	Komente të tjera nga mbikqyrësi/Çfarë mund të përmirësohet.
<p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri mbi gatimin, pijet dhe teknologji te lidhura me to</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri për përgatitjen e vendin e punës për gatim dhe shërbim.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar aftësi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve, pajisjeve dhe materialeve të punës</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi për të lexuar dhe interpretuar dokumentacionin teknik dhe sinjalistikën e profesionit.</p> <p>Praktikanti zbaton rregullat e higjienës personale, të mjeteve, pajisjeve dhe vendit të punës, sipas standardit HACCP dhe ISO.</p> <p>Praktikanti zbaton rregullat e sigurimit teknik, mbrojtjes së mjedisit e dhënies së ndihmës së parë.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në përgatitjen e gatimeve me vezë në kuzhinë.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në përgatitjen e buljoneve dhe suprave të thjeshta në kuzhinë.</p>		

Njohuria/Kompetenca e përftuar (formular si objektiv për t'u arritur)	Vlerësimi/ Arritja e Objektivit (nga 1 në 5 ⁴)	Komente të tjera nga mbikqyrësi/Çfarë mund të përmirësohet.
<p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në zbatimin e rregullave të estetikës në gatim dhe shërbim.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në rregullimin dhe shtrimin e sallës së shërbimit.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në zbatimin e rregullave të pritjes, përcjelljes dhe shoqërimit të klientit në restorant.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në parapërgatitjen e shërbimit të pijeve dhe ushqimit në restorant.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në shoqërimin e klientëve drejt recepsionit.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në shoqërimin e klientin në dhomë.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në transportimin e bagazheve të klientëve në dhomë.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në informimin e klientëve për mjediset dhe shërbimet në hotel.</p>		

Njohuria/Kompetenca e përftuar (formular si objektiv për t'u arritur)	Vlerësimi/ Arritja e Objektivit (nga 1 në 5 ⁴)	Komente të tjera nga mbikqyrësi/Çfarë mund të përmirësohet.
<p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në kryejën e rezervimeve të thjeshta sipas kërkesës së klientëve.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në kryejën e rregjistrimevetë klientëve në hotel.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në pastrimin dhe rregullimin e dhomës, tualetit dhe mjediseve të tjera të hotelit.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në kryejën e procedurave të punës për larjen dhe hekurosjen e biankerive.</p> <p>Praktikanti ka zhvilluar njohuri dhe aftësi në kryejën e procedurave të punës për pastrimin e rrobave të klientit në lavanteri.</p> <p>Kompetenca të tjera profesionale.....</p>		

Mentori i praktikës: _____

Data: _____

Praktikanti: _____

Data: _____

ANEKS V5. Format vetëraportimi nga nxënësi për zhvillimin e punës në biznes

Emri i praktikantit:

Periudha e Praktikës:

Vendi i Praktikës/Kompania:

1. Listimi i veprimtrive të kryera
2. Përshkrimi i tyre
3. Si është ndjerë nxënësi gjatë realizimit të veprimtarive ?
4. Sa i motivuar ka qenë ai ?
5. Sa dhe si ka mësuar nxënësi nga veprimtaritë?
6. Si është trajtuar nxënësi nga biznesi?
7. Si e ka ndihmuar/orientuar instruktori në biznes gjatë realizimit të veprimtarive?
8. Si kanë qenë raportet me kolegët ?

ANEKS V4. Model për përmbajtjen e praktikës në biznes

Viti	Moduli	Posti i punës	Kompetenca profesionale/RM Në përfundim të praktikës nxënësi:	Vlerësimi 1-5
I trete	Veprime të blerjes	Sektori i blerjes	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon furnitorët potencialë në fushën e biznesit - vendos dhe ruaje marrëdhënie biznesi me furnitorët. - përgatit planin e blerjes. - harton një kërkesë për blerje produkti. - kryen blerjet për biznesin dhe personelin. - kryen blerje për biznesin dhe personelin on-line - kryen veprimet për hyrjen e mallrave në magazinë. 	
	Veprime të shitjes	Sektori i shitjes	<ul style="list-style-type: none"> - identifikon klientët. - vendos dhe ruaje marrëdhënie me klientët - harton një ofertë për shitje produkti - kryen procedurat e shitjes - kryen shitje on-line. - kryen veprimet për daljen e mallrave nga magazina - përpunon reklamimet (ankesat) e klientëve. 	
	Llogaritja e kostove dhe e çmimeve në ndërmarrjen tregtare	Financa	<ul style="list-style-type: none"> - llogarit kosto të produkteve në ndërmarrjet tregtare. - llogarit kosto të tjera të aktiviteteve në ndërmarrjet tregtare. - llogarit çmimin e produkteve në ndërmarrjet tregtare. 	
	Hulumtimi i tregut	Projekt	<ul style="list-style-type: none"> - mbledh të dhënat për hulumtimin e tregut. - kryen përpunimin dhe prezantimin e të dhënave të hulumtimit 	
	Kompetenca personale		<ul style="list-style-type: none"> - komunikon në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme - përdor burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional. - nxit potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente. - angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror. 	

		<ul style="list-style-type: none"> - respekton rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integrimeve lokale, rajonale. - manifeston guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij. - tregon vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij. - organizon drejt, procesin e të nxënies të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës. - respekton parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar. <p>vlerëson dhe vetvlerëson nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.</p>	
--	--	--	--

ANEKS PV1. Plani individual i punës në biznes/ fletëvlerësimi

Moduli: _____

Emri i praktikantit: _____

Periudha e Praktikës _____

Vendi i Praktikës/Kompania: _____

Instruktori përgjegjës në biznes: _____

Qëllimi: Të aftësohen nxënësit për të kryer parapërgatitjen dhe gatimin e asortimenteve me mish

Kompetenca të përgjithshme:

- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.

Vendi i punës	RM	vlerësimi				
		1	2	3	4	5
Kuzhina e restorantit	Nxënësi identifikon pjesët e mishit sipas ndarjes anatomike të tij.					
	Nxënësi zbaton teknikat e përpunimit të mishrave, sipas pjesëve dhe recetës.					
	Nxënësi përgatit buljone me mish/shpendë.					
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me salca shoqëruese					
	Nxënësi përgatit supra					
	Nxënësi përgatit gatime me mish/shpendë, me garniturë					
	Nxënësi përgatit gatime tradicionale me mish/shpendë					
Shënime të instruktorit	<i>Këtu do të shkruhet një vlerësim me shprehje për realizimin e kompetencave të përgjithshme.</i>					

Mentori: _____

Praktikanti: _____

ANKES P2. Model plan ditari për veprimtari të ndryshme mësimore

Plan mësimor Vizitë në biznes

Drejtimi _____ Klasa _____

Koha e zhvillimit _____, _____, _____ muaji, viti

Lëndët që integrohen

- _____
- _____

Moduli: _____

Qëllimi mësimor:

Qëllimi afektiv:

Objektivat:

- _____

- _____

- _____

- _____

Metodat që do të përdoren: *(këto janë vënë si shembull)*

- Biseda hulumtuese
- Vëzhgimi i drejtpërdrejtë
- Punim i një eseje ose referati

Organizimi i punës

1. Punë paraprake:

- Bisedë me nxënësit në klasë një ditë përpara vizitës në _____.
- Biseda do të zhvillohet rreth njohurive që kanë nxënësit mbi fushën në të cilët zhvillohet veprimtaria mësimore.
Nxënësit mund të plotësojnë në mënyrë individuale pjesën e parë të: "Fletë pune 1" dhe më pas të zhvillohet biseda me ta.
- Pritshmëritë që kanë nxënësit për vizitën në _____

- Njihen nxënësit me veprimtarinë që do të zhvillojnë (Vizitë në _____) dhe u kërkohet të japin mendimin e tyre mbi pritshmëritë që kanë: - Çfarë mendoni se do të shihni? Për cilët elementë keni më shumë interes? A mendoni se vizita në _____ do të zhvillojë më shumë njohuritë që ju keni në këtë fushë? Plotësojnë nxënësit Fletë pune 2" Pritshmëritë e mia"
- c) U jepen nxënësve udhëzime e detyra të qarta për vizitën në _____ që do të jenë të bazaar në objektivat e këtij mësimi.
 - Vëzhgimi i kujdesshëm i _____
 - Fotografimi i produkteve dhe materialeve që i bëjnë më shumë përshtypje.
 - Jepen udhëzime për rregullat që duhet të zbatohen gjatë vizitës në _____ (të folurit me zë jo të lartë, të dëgjuarit me vëmendje e personit që do t'i prezantojë procedurat, makineritë, etj).

2. Zhvillimi i vizitës në _____

Mësuesi gjatë gjithë kohës ndjek me vëmendje sa të interesuar janë nxënësit dhe sa i zbatojnë rregullat në mjedisin e punës.

3. Veprimtari pas vizitës

Pas vizitës, në klasë mësuesi zhvillon bisedë me nxënësit rreth vizitës së zhvilluar në _____.

- Bisedë rreth mbresave që patën.
- Nxjerrin nxënësit "Fletë pune 2" dhe plotësojnë në kolonën e dytë sesa nga pritshmëritë e tyre u realizuan.
- U jepet nxënësve një detyrë që mbështet në vëzhgimet që bënë gjatë vizitës, si:

Ese përshkruese: "Një ditë në _____", "Si prodhohet _____" etj, në varësi të fushës e qëllimit; përcaktohet afati i kryerjes së detyrës dhe jepen kriteret e vlerësimit

4. Prezantimet

Në bazë të prezantimeve të detyrave bëhet dhe vlerësimi i çdo nxënësi nga shokët e klasës.

Punët futen në dosje.

Shënim: Vizitat në biznes zhvillohen në më shumë se një orë mësimore dhe në to integrohen më shumë se 2 lëndë të profesionit, për këtë arsye dhe objektivat që do të arrihen do të jenë më të shumta se një orë e zakonshme mësimore. (Pjesa e parë, e tretë dhe e katërt do të zhvillohen në klasë)

Aneksi V7. Fletë pune për nxënësin 1

Njohuritë e mia mbi _____

Mjete që përdoren	Procedura që ndiqen	Rregulla të profesionit

Aneks 8. Fletë pune 2: Pritshmëritë e mia

Gjatë vizitës në _____ mendoj që do të mësoj më shumë për:	
1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	

Aneks V9. Fletë pune 3

Intervistë me _____

Përgatit 3 pyetje që do t'i bësh një punonjësi të _____, i cili do vijë për një bisedë në klasë.

1. _____
2. _____
3. _____

Aneks P7. Plan mësimor: Bisedë me një profesionist

Drejtimi _____ Klasa _____

Koha e zhvillimit _____, _____, _____ (muaji, viti)

Lënda: _____

Moduli: _____

Qëllimi mësimor:

Qëllimi afektiv:

Objektivat:

- _____

- _____

- _____

Metodat që do të përdoren: (këto janë vënë si shembull)

- Shpjegim
- Bisedë
- Diskutim

Organizimi i punës

5. Punë paraprake:

a) Bisedë me nxënësit në klasë një ditë përpara vizitës së _____.

- Biseda do të zhvillohet rreth njohurive që kanë nxënësit mbi fushën në të cilët zhvillohet veprimtaria mësimore.

b) Pritshmëritë që kanë nxënësit për vizitën e _____

- Njihen nxënësit me veprimtarinë që do të zhvillojnë (Bisedë me _____) dhe u kërkohet të japin mendimin e tyre mbi pritshmëritë që kanë:- Çfarë mendoni se do të mësoni nga takimi me _____? Për cilët elementë keni më shumë interes të flasë? A mendoni se biseda me _____ do të zhvillojë më shumë njohuritë që ju keni në këtë fushë?

Plotësojnë nxënësit Fletë pune 1 "Pritshmëritë e mia"

c) U kërkohet nxënësve që në mënyrë individuale të shkruajnë të paktën 1 pyetje që do t'ia drejtojnë të ftuarit.

d) U jepen nxënësve udhëzime paraprake për takimin me _____ (të dëgjojnë me vëmendje, të mbajnë shënime, etj)

c) Zhvillimi i bisedës me _____

Mësuesi gjatë gjithë kohës ndjek me vëmendje sa të interesuar janë nxënësit dhe i drejton për të bërë pyetjet e përgatitura paraprakisht.

d) Veprimtari pas bisedës

Pas bisedës në klasë mësuesi zhvillon bisedë me nxënësit.

- Mbresat që patën.
- Nxjerrin nxënësit "Fletë pune 1" dhe plotësojnë në kolonën e dytë sesa nga pritshmëritë e tyre u realizuan.
- Duke u nisur nga shënimet që kanë mbajtur gjatë bisedës, plotësojnë "Fletë pune 2"
- U jepet nxënësve një detyrë që mbështet në informacionin e marrë gjatë bisedës me _____, si:

Ese përshkruese: "Sot unë mësova që _____", " Të bëhesh _____" etj, në varësi të fushës e qëllimit; Përcaktohet afati i kryerjes së detyrës dhe jepen kriteret e vlerësimit

e) Prezantimet

Në bazë të prezantimeve të detyrave bëhet dhe vlerësimi i çdo nxënësi nga shokët e klasës.

Punët futen në dosje.

Shënim: *Biseda me një të ftuar në klasë zhvillohet në një orë mësimore, por për që të arrihet qëllimi i mësimin, është e nevojshme që mësuesi të planifikojë dhe në një orë paraprake dhe një orë ose 2 (në varësi të orëve në dispozicion) për veprimtari pas bisedës me të ftuarin).*

Aneks V10. Fletë pune 1

Pritshmëritë e mia

Gjatë bisedës me _____ mendoj që do të mësoj më shumë për:	
1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	

Fletë pune 2

Pyetjet	Përgjigjet

<p>Më shumë mbresa më la</p> <hr/> <hr/> <hr/> <hr/>	

Aneks V8. Model plan ditar për orë që realizohen në mjediset e shkollës

ORË DITARI	
Ora	Datë:
.....	
Klasa	
Moduli:	
RM:	
Kohëzgjatja:	
Veprimtaria mësimore:	
.....	
.....	
.....	
.....	
Hapat e punës:	
.....	
.....	
.....	
Instrumentet e vlerësimit:	
.....	
.....	
.....	
Kërkesa për realizimin dhe vendi:	
.....	
.....	